


Mbledhja e parë e Këshillit Koordinues të Diasporës



Në kuadër të Ditës Kombëtare të Diasporës në Shqipëri, më 18 dhjetor, u zhvillua mbledhja e parë e Këshillit Koordinues të Diasporës, me qëllim diskutimin për ecurinë e mëtejshme të punës dhe funksionimin e këtij Këshilli. Mbledhja u hap nga Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, i cili në fjalën e tij, falënderoi anëtarët e Këshillit për kontributin e tyre të deritanishëm. Më tej, ministri Majko theksoi se Këshilli Koordinues i Diasporës është një strukturë e re, e cila funksionon për herë të parë në historinë e shtetit shqiptar dhe synon mbrojtjen dhe forcimin e marrëdhënieve me Diasporën shqiptare. "Diaspora shqiptare jep një kontribut me rëndësi në zhvillimin e vendit të origjinës në të gjitha fushat, përfshirë arsimin, kulturën dhe ekonominë", tha ministri. Mbledhja u drejtua nga anëtari i Këshillit, z. Mark Gjonaj, i cili u ndal tek rëndësia e Diasporës shqiptare në fusha të ndryshme të vendit dhe angazhimin që duhet të kenë anëtarët e këtij Këshilli në forcimin e marrëdhënieve të Diasporës me institucionet shtetërore shqiptare. Takimin e përshëndeti Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Ilir Meta dhe Kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama, të cilët theksuan rolin e Diasporës si thesar i çmuar i Shqipërisë dhe solidaritetin dhe kontributin e saj me familjet e prekura nga tërmeti. Gjithashtu, pjesë e takimit ishte edhe Drejtuesi i Operacionit të Emergjencës rreth situatës së pas tërmetit, z. Bledi Çuçi, i cili bëri një përmbledhje të shkurtër të menaxhimit të situatës pas tërmetit në Shqipëri, përfshirë shpëtimin, trajtimin shëndetësor, strehimin e qytetarëve dhe vlerësimin e dëmeve. Me rëndësi, nga kjo mbledhje ishte miratimi i Rregullores së Këshillit dhe zgjedhja e drejtuesve të tij.

Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#); Play store [këtu](#);

ZGJIDHEN DREJTUESIT E KKD-SË



Nënkryetare
znj. Anila Hyka Smorgrav

Përfaqëson Diasporën shqiptare në Francë është profesioniste në fushën e IT-së dhe telekomit. Studimet e saj i mbaroi me rezultate të shkëlqyera në Oslo për IT, ku filloi dhe të punojë si pedagoge pranë këtij institucioni. Është diplomuar dhe me master në MBA në ESCP Evropë, një nga shkollat më prestigjioze të biznesit në Evropë. Njëkohësisht, ajo drejton projekte dhe shërben su konsulente biznesesh të rëndësishme në gjithë Evropën. Prej disa vitesh, znj. Smorgrav është aktiviste e organizatave shqiptare në Diasporë, ku dhe drejton shoqatën franko-shqiptare "Albania" në Paris.



Kryetar
z. Mark Gjonaj

Përfaqësues i Diasporës shqiptare në SHBA dhe mban postin e këshilltarit në Këshillin e Bashkisë së Nju-Jorkut. I diplomuar në "Saint John's University", z. Gjonaj është i pari shqiptaro-amerikan në bashkinë e Nju Jork-ut i zgjedhur që prej 2017. Në vitet 2012-2017, ai ka qenë anëtar i asamblesë së shtetit të Nju Jork-ut. Gjithashtu, është aktivist i hershëm në çështjen e Diasporës shqiptare në shërbime filantropike duke dhënë një kontribut të vazhdueshëm për kauzën shqiptare.



Sekretare
znj. Adriana Fishta-Bejko

Përfaqëson Diasporën shqiptare në Kanada është mësimdhënëse, autore dhe studiuese shkencore në Kanada. Gjatë 42 viteve si edukatore ka arritur të krijojë raporte me drejtues në fushën e arsimit, prindërve dhe nxënësve, duke pasur influencë pozitive në vende të ndryshme të botës me mësimdhënie në disa shtete. Për arritjet e saj në fushën e arsimit, në vitin 2002, ajo u laureua me çmimin "Who's who" për kontinentin Amerikan dhe çmimin e dytë për "Emigrant of Achievement", Calgary, Alberta. Në maj të 2018-ës, ajo u zgjodh kryetare e bordit të shkollës "Foleja e Shqiponjave" në Calgary, Alberta.

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#); Play store [këtu](#);

Këshilli Koordinues i Diasporës në konferencë për median



Këshilli Koordinues i Diasporës mbajti konferencë për median për të informuar mbi ecurinë e takimit të parë të Këshillit në datë 18 dhjetor dhe procesin e mëtejshëm të punës në adresimin e çështjeve me rëndësi për Diasporën. "Këshilli njihet zyrtarisht nga shteti shqiptar dhe do të punojë në disa tema kryesore, si votimi i diasporës në zgjedhjet e ardhshme, dyshtetësia, dhe përfshirja e përfaqësuesve të diasporës në institucionet e shtetit shqiptar", tha kryetari i Këshillit, z. Gjonaj, përfaqësues i Diasporës shqiptare në SHBA. Krahas tij, pjesë e Këshillit janë edhe 14 anëtarë të tjerë, të cilët kanë status të veçantë dhe përfaqësojnë komunitet shqiptare në vendet e ndryshme të botës.

Për të kontribuar në ndihmë të familjeve të prekura nga tërmeti



Kontributet vullnetare dhe ndihmat për familjet, mund të bëhen me shpejtësi në rrugë digjitale, në tre kategoritë e veçanta të hapura për grumbullimin e ndihmave në portalin "e-Albania".

Aktiviteti në ndihmë të fëmijëve të prekur nga tërmeti



Ministri i Shteti për Diasporën, z. Pandeli Majko, mori pjesë në aktivitetin "I buzëqeshim të ardhmes së bashku", organizuar nga Alpha Bank Albania në qytetin e Durrësit. Aktiviteti ishte në formën e një pritje festive dhe u shoqërua me shpërndarjen e dhuratave për festat e fundvittit për fëmijët e prekur nga tërmeti i 26 nëntorit.

U zhvillua konferenca vjetore e Avokatit të Popullit



Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, mori sot pjesë në Konferencën vjetore të Avokatit të Popullit "Liria pa urrëjtje-Liria e shprehjes përballë të të drejtave të tjera të njeriut". Të pranishëm ishin Presidenti i Republikës, z. Ilir Meta, Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, drejtues të institucioneve kushtetuese e shtetërore, ambasadorë dhe përfaqësues të trupit diplomatik, përfaqësues të medias dhe shoqërisë civile. Konferenca trajtoi nevojën e shmangies së gjuhës së urrëjtjes në ligjërimin publik, media, marrëdhëniet dhe institucionet politike e shoqërore.

Mbledhja e radhës e Grupit të Koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës



Grupi i Koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës, kryesuar nga ministri i Shtetit për Diasporën, zhvilloi mbledhjen e fundit për këtë vit. Grupi i Koordinatorëve, i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Shtetit për Diasporën, Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe nga zëvendësministrat e ministrive të linjës si edhe dy ekspertë të fushës, është përgjegjës për bashkërendimin e punës për zbatimin e masave të Planit të Veprimit të Strategjisë në institucionet përkatëse. Çështjet kryesore të rendit të ditës ishin publikimi i numrit të katërt të Buletinit për zbatimin e masave, problematika lidhur me zbatimin e masave dhe publikimi i raportit "Diaspora e Shqipërisë në Shifra" nga INSTAT.

Hartohet draft propozimi për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë



Grupi Ndërinstitucional i Punës, ngritur me Urdhrin nr. 124, datë 18.09.2019, finalizoi draftin e propozimeve lidhur me hartimin e paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Propozimet e grupit iu nisën Komisionit të Reformës Zgjedhore më datë 17 dhjetor. Ky grup u kryesua nga ministri i Shtetit për Diasporën dhe në përbërje të tij kishte specialistë nga Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Infrastrukturs dhe Energjisë dhe Instituti i Statistikave.

Qendra e Botimeve për Diasporën mundëson falas shërbimin e mësimdhënies në distancë për të gjithë mësuesit dhe Shkollat e Gjuhës Shqipe në Diasporë



Për herë të parë, të gjithë mësuesit dhe Shkollat e Gjuhës Shqipe në Diasporë përfitojnë falas shërbimin e mësimdhënies në distancë përmes Platformës Digjitale "Schoolme", mundësuar nga Qendra e Botimeve për Diasporën. Përmes këtij shërbimi, mësuesit do të kenë mundësi të risin cilësinë e mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe të krijojnë një forum të përbashkët komunikimi dhe shkëmbimi informacioni. Platforma mundëson shpërgjimin e lëndëve të ndryshme në gjuhën shqipe nga mësues të kualifikuar, duke pasur në dispozicion video shkencore, filma, imazhe, dokumente, harta specifike, për një shpëllim më të thellur dhe më të përcitësuar të të gjitha temave mësimore të renditura sipas programit shkollor të miratuar nga institucionet arsimore përgjegjëse të Shqipërisë dhe Kosovës. Qendra e Botimeve për Diasporën, do të ndihmojë në përhapjen e mësimit të gjuhës shqipe në të gjitha nivelet për komunitetet shqiptare në Diasporë.

KKD / Rosario Petta ftesë për mbledhjen e fondeve



Rosario Petta anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe kryetar i komunës së "Plana degli Albanesi", së bashku me disa komuna arbëreshe si edhe me organizatën "Caritas", po ndërmarrin nisura për të ndihmuar familjet shqiptare të prekura nga tërmeti. Përveç ndihmës së tyre, komunat arbëreshe po sensibilizojnë edhe qytetarët për të kontribuar.